



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS

Numri i lëndës: 2024:116855
Datë: 05.08.2024
Numri i dokumentit: 06019505

Kom.Dh.Shk.II.nr.808/2024

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS, Dhoma e Shkallës së Dytë, me gjyqtari individual Faton Bajrami, në çështjen përmbartimore të kreditorit N.T.P. Binjaket, me seli në Mitrovicë, kundër debitorit TehnoBurimi, me seli në Mitrovicë, rr. “Kulla e Malokve” Shupkovc, me bazë juridike përmbartimore, duke vendosur lidhur me ankesën e debitorit, të ushtruar kundër aktvendimit të Gjykatës Komerciale të Kosovës - Dhomat e Shkalles së Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike, KPPP.nr.955/23, të datës 25.09.2023, me datë 05.08.2024, mori këtë:

A K T V E N D I M

REFUZOHET si e pathemeltë ankesa e debitorit TehnoBurimi, me seli në Mitrovicë, ndërsa aktvendimi i Gjykatës Komerciale të Kosovës - Dhomat e Shkalles së Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike, KPPP.nr.955/23, të datës 25.09.2023, **VËRTETOHET**.

A r s y e t i m

Gjykata Komerciale e Kosovës – Dhomat e Shkalles së Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike, me aktvendimin e atakuar KPPP.nr.955/23, të datës 25.09.2023, në pikën I të dispozitivit, e ka refuzuar si të pa bazuar prapësimin e debitorit TehnoBurimi, me seli në Mitrovicë, i ushtruar kundër Urdhrit të Përmbartuesit Privat Atip Mustafa P.nr.702/2023 të dt. 18.05.2023, dhe me pikën II, ka mbetur në fuqi urdhrin përmbartimor të Përmbartuesit Privat Atip Mustafa P.nr.702/2023 të dt. 18.05.2023.

Kundër këtij aktvendimi, në afatin ligjor ka ushtruar ankesë debitori, për shkak të shkeljeve thelbësore të dispozitave të procedurës, konstatimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike dhe për shkak të aplikimit të gabuar të së drejtës materiale, me propozim që gjykata e shkallës së dytë, ta aprovojë si të bazuar ankesën e debitorit, dhe kjo çështje ti kthehet gjykatës së shkallës së parë në rivendosje.

Përgjigje në ankesë nuk ka paraqitur pala kreditori.

Gjykata Komerciale, përmes gjyqtarit individual, i shqyrtoi shkresat e lëndës, aktvendimin e ankimuar dhe pretendimet ankimore, në kuptim të nenit 194 e 208 të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK), e lidhur me nenin 17 dhe nenin 3 paragrafi 2 të Ligjit nr.04/L-139 për Procedurën Përmbartimore (LPP) dhe gjeti se:

Ankesa e debitorit është e pathemeltë.

Nga shkresat e lëndës rrjedh se kreditori, ka paraqitur propozim për përmbartim, kundër debitorit, në bazë të dokumentit të besueshëm – Faturës nr. 131/23 te datës 15.02.2023, Faturës nr. 128/23 te datës 14.02.2023, Faturës nr. 110/23 te datës 09.02.2023, Faturës nr. 106/23 te datës 08.02.2023, Faturës nr.98/23 te datës 04.02.2023, Faturës nr.95/23 te datës 04.02.2023, Faturës nr.94/23 të datës 04.02.2023, Faturës nr.91/23 te datës 03.02.2023, Faturës nr.90/23 te datës 03.02.2023, Faturës nr.89/23 te datës 03.02.2023, Faturës nr.83/23, te datës 02.02.2023, Faturës nr.82/23 te datës 01.02.2023, Faturës nr. 69/23 te datës 26.01.2023, Faturës nr. 57/23 te datës 21.01.2023, Faturës nr.1204/22 te datës 21.12.2022, Faturës nr.373/22 te datës 07.05.2022, Faturës nr.230/22 te datës 25.03.2022, Faturës nr.224/22 te datës 24.03.2022, Faturës nr.196/22 te datës 17.03.2022, Faturës nr.140/22 te datës 21.02.2022, Faturës nr. 134/22 te datës 19.02.2022, Faturës nr.133/22 te datës 18.02.2022, Faturës nr. 130/22 të datës 18.02.2022, Faturës nr.124/22 te datës 15.02.2022, Faturës nr. 1192/21 te datës 10.12.2021, Faturës nr.463/21 te datës 04.06.2021, Faturës nr.385/21 te datës 21.05.2021, Faturës nr.14/21 te datës 08.01.2021, Faturës nr.716/20 te datës 17.11.2020, Faturës nr. 614/20 te datës 16.10.2020, Faturës nr.584/20 te datës 09.10.2020, Faturës nr. 545/20 të datës 30.09.2020, Faturës nr.529/20 te datës 28.09.2020, Faturës nr.433/20 te datës 26.08.2020, Faturës nr. 404/20 te datës 15.08.2020 dhe Faturës nr.403/20 të datës 15.08.2020, në emër borxhit për shumën e mjetëve, në lartësi prej 4.490.05 euro, që debitori në afat prej 7 ditësh nda dita e pranimit të urdhërit t'ia paguaj me kamatë ligjore prej 8%, si dhe te gjitha shpenzimet e procedurës përmbartimore.

Përmbartuesi privat Atip Mustafa, duke vepruar në bazë të propozimit për përmbartim të kreditorit me urdhrin P.nr.702/2023 të dt. 18.05.2023, ka lejuar përmbartimin e propozuar nga kreditori, ndërsa debitori ka ushtruar prapësim duke theksuar se për këto fatura ka pasur më përpara në përmbartim me lëndën nr.1125/21, sepse faturat janë të paguara nëpërmjet bankës dhe me kesh pjesën tjetër si në kartelën e bashkangjitur për furnizim, andaj i propozon gjykatës që të pezulloj çështjen përkohësisht.

Përgjigje në prapësim nuk ka ushtruar kreditori.

Gjykata Komerciale e Kosovës – Dhomat e Shkalles se Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike, duke vendosur lidhur me prapësim e debitorit dhe përgjigjen në prapësim të kreditorit, ka nxjerrë aktvendimin e atakuar KPPP.nr.955/23, të datës 25.09.2023, në pikën I të dispozitivit, e ka refuzuar si të pa bazuar prapësimin e debitorit TehnoBurimi, me seli në Mitrovicë, i ushtruar kundër Urdhrit të Përmbartuesit Privat Atip Mustafa P.nr.702/2023 të dt. 18.05.2023, dhe me pikën II, ka mbetur në fuqi urdhrin përmbartimor të Përmbartuesit Privat Atip Mustafa P.nr.702/2023 të dt. 18.05.2023.

Në arsyetim të aktvendimit të atakuar gjykata ka theksuar se me shikim në shkresat e lëndës, deklarimet e palëve ndërgjyqëse, ka vlerësuar se në rastin konkret kemi të bëjmë me propozim për përmbartim të dokumentit të besueshëm - Fatura e lartë cekur, në emër borxhit për

shumën e mjeteve, në lartësi prej 4.490.05 euro, mbi bazë të së cilës përmbaruesi privat e ka lejuar përmbarimin, por ky dokument përbën bazë juridike për caktimin e përmbarimit, ngase i ka plotësuar kushtet ligjore nga neni 29 par 1, 3 dhe 37 të LPP-së, për faktin se ky dokument e ka cilësinë e dokumentit përmbarimor, e po ashtu nga shiqimin në këtë dokument rezulton se përmban të gjitha elementet e kërkuar nga këto nene, të cilat janë përshkruar shërbimet, shumën e detyrimi dhe kohen e përmbushjes dhe fatura është pranuar nga debitori në mënyrë të rregullt. Andaj edhe mbi bazën e këtyre fakteve gjykata e shkallës së parë e ka refuzuar prapësimin e debitorit dhe ka mbet në fuqi urdhrin përmbarimor.

Gjykata Komerciale e Kosovës, Dhomat e Shkalles se Dyte, vlerëson se gjykata e shkallës së parë, në bazë të provave të cilat gjinden në shkresat e lëndës, ka dhënë aktvendim të drejtë dhe të bazuar në dispozita konkrete ligjore, prandaj konkludimin e gjykatës së shkallës së parë, lidhur me këtë çështje e pranon edhe Gjykata Komerciale-Dhoma e Shkallës së Dytë, duke vlerësuar po ashtu se aktvendimi i atakuar është i rregullt dhe i ligjshëm, për arsye se i njëjti nuk është përfshirë në shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182, paragrafi 1 dhe 2 të LPK-së, dhe se drejtë është vërtetuar gjendja faktike, kështu që mund të hetohet dhe vlerësohet ligjshmëria e tij, shkelje të cilat gjykata e shkallës së dytë i heton sipas detyrës zyrtare në bazë të nenit 194 të LPK-së.

Gjykata Komerciale – Dhoma e Shkallës së Dytë vlerëson se në rastin konkret kemi të bëjmë me propozim për përmbarim, që është në përputhje me dispozitën nga nenin 37 i Ligjit për Procedurën Përmbarimore nr.04/L-139, ku Përcakton se, Kur propozimi për përmbarim paraqitet në bazë të dokumentit të besueshëm, mjafton që propozimit t'i bashkëngjitet dokumenti i tillë origjinal apo kopja e tij e vërtetuar sipas ligjit, pra dokumenti në fjalë fatura është dorëzuar në origjinal. Gjithashtu në bazë të dokumentit të besueshëm- Faturës nr. 131/23 te datës 15.02.2023, Faturës nr. 128/23 te datës 14.02.2023, Faturës nr. 110/23 te datës 09.02.2023, Faturës nr. 106/23 te datës 08.02.2023, Faturës nr.98/23 te datës 04.02.2023, Faturës nr.95/23 te datës 04.02.2023, Faturës nr.94/23 të datës 04.02.2023, Faturës nr.91/23 te datës 03.02.2023, Faturës nr.90/23 te datës 03.02.2023, Faturës nr.89/23 te datës 03.02.2023, Faturës nr.83/23, te datës 02.02.2023, Faturës nr.82/23 te datës 01.02.2023, Faturës nr. 69/23 te datës 26.01.2023, Faturës nr. 57/23 te datës 21.01.2023, Faturës nr.1204/22 te datës 21.12.2022, Faturës nr.373/22 te datës 07.05.2022, Faturës nr.230/22 te datës 25.03.2022, Faturës nr.224/22 te datës 24.03.2022, Faturës nr.196/22 te datës 17.03.2022, Faturës nr.140/22 te datës 21.02.2022, Faturës nr. 134/22 te datës 19.02.2022, Faturës nr.133/22 te datës 18.02.2022, Faturës nr. 130/22 të datës 18.02.2022, Faturës nr.124/22 te datës 15.02.2022, Faturës nr. 1192/21 te datës 10.12.2021, Faturës nr.463/21 te datës 04.06.2021, Faturës nr.385/21 te datës 21.05.2021, Faturës nr.14/21 te datës 08.01.2021, Faturës nr.716/20 te datës 17.11.2020, Faturës nr. 614/20 te datës 16.10.2020, Faturës nr.584/20 te datës 09.10.2020, Faturës nr. 545/20 të datës 30.09.2020, Faturës nr.529/20 te datës 28.09.2020, Faturës nr.433/20 te datës 26.08.2020, Faturës nr. 404/20 te datës 15.08.2020 dhe Faturës nr.403/20 të datës 15.08.2020, ku me dispozitën e nenit 29 par. 1 dhe 3 të Ligjit për Procedurën Përmbarimore nr.04/L-139, përcaktohet paragrafi 1 se Përmbarimi me qëllim të realizimit të kërkesës në të holla caktohet në bazë të dokumentit të besueshëm sipas LPP-së. Ndërsa sipas paragrafi 3 përcaktohet se, Dokumenti i besueshëm, është i përshtatshëm për përmbarim po që se në të është treguar kreditori dhe debitori si dhe objekti, lloji, shuma dhe koha e përmbushjes së detyrimit monetar, e në rastin konkret kemi të bëjmë me dokumentin- fatura e cila paraqet dokument të besueshëm, pasi që e njëjta është treguar debitori, përkatësisht i njëjti përmban të gjitha elementet të mjaftueshëm në kuptim të plotësimit sipas neneve të lartëcekura nga LPP-ja. E po ashtu edhe

gjkata e shkallës së dytë, pajtohet në tërësi me qëndrimin juridik të gjykatës së shkallës së parë ky dokument përbën bazë juridike për caktimin e përmbartimit, ngase i ka plotësuar kushtet ligjore nga neni 29 par. 1 dhe 3 dhe 37 të LPP-së, për faktin se ky dokument e ka cilësinë e dokumentit përmbartimor në origjinal dhe është pranuar nga ana e debitorit në mënyrë të rregullt duke e nënshkruar si institucion.

Kjo gjykatë vlerëson se palët ndërgjyqëse mund të iniciojnë procedurë në gjykatën kompetente, për ti provuar pretendimet e tyre rreth mos përmbushjes së detyrimeve që dalin nga raporti detyrimor dhe se fatura në fjalë, në këtë fazë, duke pasur parasysh çështjet kontestuese të lartcekura, si të tilla, janë të përshtatshme për përmbartim, siç me të drejtë konstatoj edhe gjykata e shkallës së parë. Andaj, nga të cekurat kjo gjykatë vlerësoj se aktvendimi i gjykatës së shkallës së parë duhet vërtetuar dhe të refuzohet ankesa e debitorit si e pathemeltë.

Gjykata e shkallës së dytë i shqyrtoi edhe pretendimet tjera ankimore të debitorit, por të njëjtat nuk ndikuan në një vendim ndryshe.

Nga sa u tha me lartë u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi në kuptim të nenit 77 dhe 17 të LPP-së, lidhur me nenin 208 dhe 209, pika b), të LPK-së.

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS
Dhoma e Shkallës së Dytë
Kom.Dh.shk.II.nr.808/2024, me datë 05.08.2024

Gjyqtari,
Faton Bajrami, d.v